



Kosovë: Deklaratë përmbyllëse e misionit të nenit IV më 2017

13 dhjetor 2017

Deklarata përmbyllëse përshkruan gjetjet preliminare të stafit të FMN në fund të vizitës zyrtare (apo 'misionit'), në shumicën e rasteve në shtetin anëtar. Misionet realizohen si pjesë e konsultimeve të rregullta (zakonisht vjetore) në kuadër të [nenit IV](#) të FMN Nenet e Marrëveshjes, në kontekst të kërkesës për të shfrytëzuar resurset e FMN (huamarrje nga FMN), si pjesë e diskutimeve të programeve të monitoruara të stafit, apo si pjesë e monitorimeve të tjera të stafit të zhvillimeve ekonomike.

Autoritetet kanë dhënë pëlqimin e tyre për publikimin e kësaj deklarate. Mendimet e shprehura në këtë deklaratë janë të stafit të FMN dhe nuk paraqesin medoemos mendimet e Bordit Ekzekutiv të FMN. Bazuar në gjetjet preliminare të këtij misioni, stafi do të përgatitë një raport i cili, nëse merr aprovimin e menaxhmentit, do të prezantohet para Bordit Ekzekutiv të FMN për diskutim dhe vendimmarrje.

Një mision i FMN, nën udhëheqje të Stephanie Eble, vizitoi Prishtinën gjatë periudhës 29 nëntor deri 12 dhjetor për të mbajtur diskutime konsultuese në kuadër të nenit IV 2017. Misioni i FMN-së është mirënjohës ndaj autoriteteve dhe palëve të tjera homologe për bashkëpunimin e tyre të shkëlqyeshëm, diskutimet e sinqerta dhe të hapura, si dhe për mikpritjen e tyre.

Kosova ka shënuar progres të konsiderueshëm gjatë viteve të fundit, përfshirë në kuadër të Marrëveshjes së fundit 'Stand-by', duke siguruar disiplinë fiskale, forcim të shëndetit dhe qëndrueshmërisë së sektorit financiar, si dhe rritje më të madhe. Tani, politikat duhet të fokusohen në reforma për përmirësim të aftësisë konkurruese për të mbyllur hendekun, zvogëluar pabarazinë e të ardhurave, si dhe për të pasur rritje më të fortë dhe më përfshirëse. Kjo do të kërkojë masa për përmirësim të mëtejshëm të produktivitetit dhe veprimtarisë së sektorit privat; avancim të mëtejshëm të përbërjes buxhetore në kuadër të limiteve të rregullës fiskale; dhe mbështetje të thellimit financiar, duke ruajtur stabilitetin e sektorit financiar.

Zhvillimet dhe pasqyra makroekonomike

Rritja pritjet të arrijë 4.1 për qind më 2017, në mesin e më të lartave në rajon, nxitur nga investimet dhe eksportet e larta. Rritja e vazhduar e hyrjeve të remitancave dhe huadhënies bankare gjithashtu ka mbështetur këtë zhvillim. Inflacioni total është rritur më çmimet më të larta ndërkombëtare të ushqimit dhe lëndës djegëse dhe pritjet të arrijë mesatare prej 1.5 për qind këtë vit.

Perspektiva afatmesme është e favorshme por i nënshtrohet disa rreziqeve. Bazuar në objektivat aktuale të politikave (disiplina fiskale dhe reformat graduale strukturore), rritja reale e BPV pritet të qëndrojë në 4 për qind, nxitur nga konsumi privat dhe investimet, ndërsa eksportet shënojnë kontribut gjithnjë e më të madh në rritje. Inflacioni parashikohet të mbetet pak mbi mesataren e eurozonës prej 1.8 për qind, duke reflektuar fitime të moderuara të produktivitetit. Gjersa kjo perspektivë është relativisht e favorshme, nevojitet rritje më e madhe për të përshpejtuar krijimin e vendeve të punës dhe për të rritur të ardhurat. Rritja afatmesme mund të tejkalojë 4 për qind nëse realizohet projekti i planifikuar i termocentralit të ri të energjisë elektrike dhe reformat që tërheqin më shumë investime të huaja dhe vendore të sektorit privat dhe që mobilizojnë financim më të madh të IFN për projektet kryesore kapitale. Megjithatë, rreziqet për stabilitetin politik mund të minojnë besimin dhe të ndalojnë reformat. Gjithashtu, presionet e shpenzimeve sociale mund të tkurrin shpenzimet produktive. Për më tepër, varësia në remitancat vazhdon ta lë Kosovën të cenueshme ndaj goditjeve të mundshme të jashtme.

Progres në reformat e kohëve të fundit, por vazhdojnë të mbesin sfida të rëndësishme

Kosova ka shënuar progres të konsiderueshëm në fuqizimin e rritjes ekonomike, duke frenuar deficitin fiskal dhe rritur shpenzimet në infrastrukturë, si dhe duke avancuar stabilitetin dhe thellimin e sektorit financiar. Për më tepër, është shënuar progres në reforma strukturore, siç janë iniciimi i prokurimit më transparent publik (ndonëse çalon zbatimi), miratimi i ligjit të ri për falimentimin, si dhe fuqizimi i zbatimit të kontratave.

Megjithatë, vazhdojnë të mbesin sfida të rëndësishme strukturore. Konkurrueshmëria e dobët e jashtme, informaliteti, dobësitë në qeverisje, pjesëmarrja e ulët e fuqisë punëtore dhe shkallët e larta të papunësisë veçanërisht tek të rinjtë, vazhdojnë të kufizojnë potencialin e Kosovës për rritje. Zgjidhja e këtyre problemeve strukturore është e nevojshme për të zhvilluar një sektor privat produktiv dhe të orientuar drejt eksporteve për të përshpejtuar konvergjencën e të ardhurave me atë të Bashkimit Evropian.

Misioni ka diskutuar prioritetet vijuese të reformave:

Reformat strukturore: Përmirësimi i klimës investuese, qeverisjes dhe aftësisë konkurruese

Kosova duhet të përmirësojë tutje mjedisin e biznesit. Përderisa radhitja e Kosovës në treguesit e Bankës Botërore të “Të bërit biznes” është përmirësuar ndjeshëm, në disa fusha, këto përmirësime reflektojnë ndryshimet legjislative dhe rregullative, të cilat duhet të zbatohen në praktikë për të avancuar tutje mjedisin e biznesit. Zbatimi i ndryshimeve të fundit legjislative do të zvogëlojë koston e të bërit biznes dhe do të sigurojë rregulla të barabarta për debitorët dhe kreditorët.

Gjithashtu, qeverisja më e mirë dhe gjyqësori më efikas mund të ndihmojnë në tërheqjen e investimeve shumë të nevojshme. Në këtë kuptim, duhet të përdoret platforma e detyrueshme e prokurimit elektronik, të fuqizohet efektiviteti i agjencisë kundër korrupsionit dhe deklarimit

të pasurisë, dhe projektet e mëdha të investimeve publike duhet t'i nënshtrohen auditimeve *ex-post*.

Trajtimi i fytave të ngushtë në energji dhe infrastrukturë do të mbështesë aktivitetin e sektorit privat dhe forcimin e aftësisë konkurruese. Kjo kërkon që përfundimisht të realizohet termocentrali i shumë-vonuar dhe të mbrohet hapësira në buxhet për investime prioritare.

Duhet të realizohen planet për uljen e joefikasitetit në sektorin e ndërmarrjeve publike dhe ato janë kritike për të përmirësuar perspektivën e rritjes dhe për të zvogëluar rreziqet fiskale. Prioritetet e reformës përfshijnë përmirësimin e qeverisjes duke forcuar pavarësinë e bordeve mbikëqyrëse, publikimin në kohë të pasqyrave financiare, auditimet e jashtme dhe uljen e ndjeshme të kostove operative duke optimizuar punësimin dhe ulur faturën e lartë të pagave. Kjo gjithashtu do të hapë rrugën për përfshirjen e sektorit privat në periudhën afatmesme, duke përfshirë privatizimin. Po ashtu, struktura institucionale dhe qeverisëse e Agjencisë së Privatizimit duhet të forcohet për të përshpejtuar procesin e ngadaltë të privatizimit/likuidimit.

Reformat e planifikuara me fokus në rritjen e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore dhe trajtimin e papunësisë janë të mirëseardhura. Me qëllim të zvogëlimit të shkallës së lartë të papunësisë, veçanërisht tek të rinjtë dhe për të rritur pjesëmarrjen e ulët të gruas në tregun e punës, misioni mirëpret planin e veprimit të qeverisë me fokus në trajnime profesionale, politika aktive të tregut të punës dhe rritjen e kopshteve për fëmijë me kosto të përballueshme, si dhe bën thirrje për zbatim të shpejtë.

Krahas këtyre masave, çdo rritje e ardhshme e pagës minimale duhet të jetë në përputhje me mekanizmin aktual të përcaktimit të pagës minimale të bazuar në rregulla, duke marrë parasysh nivelin ende të lartë të papunësisë, hendekun e madh të konkurrencës dhe kuadrin e dobët të zbatimit. Rritjet e mëdha diskrecionale të pagës minimale, në periudhë afatmesme, mund t'i vënë punëtorët me shkathtësi të ulëta në pozitë të pafavorshme dhe të rrisin papunësinë e të rinjve, si dhe të krijojnë presione në përfitimet veçse të larta sociale, duke tkurrur shpenzimet më prioritare në buxhet.

Politika fiskale: Mbështetja e rritjes ekonomike përmes makro-stabilitetit dhe politikat strukturore tatimore dhe të shpenzimeve

Pozicioni fiskal mbetet adekuat nga perspektiva e stabilitetit ekonomik dhe e zhvillimit, dhe "rregulla fiskale" është garancë e përshtatshme për politikën fiskale. Në përputhje me buxhetin suplementar, deficitin buxhetor i vitit 2017 (përkufizimi i rregullës fiskale) pritet të jetë rreth 1.5 për qind e BPV, që është nën tavanin e deficitit të rregullës fiskale prej 2 për qind të BPV. Projektbuxheti për vitin 2018 synon një deficit prej 1.8 për qind të BPV, në përputhje me rregullat fiskale. Projektbuxheti gjithashtu mban konstante *faturën e pagave* si përqindje e BPV, në përputhje me rregullën e pagave. Autoritetet presin të fillojnë me shfrytëzimin e investimeve të financuara nga donatorët dhe privatizimet (që janë të përjashtuara nga tavanin e deficitit të rregullës fiskale) për të trajtuar hendekun e madh të infrastrukturës. Me supozimin se janë trajtuar vështirësitë e kaluara në mobilizimin e këtyre burimeve, shpenzimet e tilla në projekte mund të arrijnë 1 përqind të BPV vitin e ardhshëm. *Bilancet bankare* janë rivendosur në nivel të matur prej 4.5 për qind të BPV dhe pritet të qëndrojnë në atë nivel.

Megjithatë, përbërja e përgjithshme e buxhetit duhet të përmirësohet me kalimin e kohës. Presionet për më shumë shpenzime sociale janë të larta dhe kundrejt kufizimeve të të hyrave mund të tkurrin shkallën e nevojshme të investimeve në arsim, shëndetësi dhe infrastrukturë, që janë kritike për të përmirësuar produktivitetin dhe rritjen. Në këtë drejtim, misioni rekomandon masat strukturore si në vijim:

- **Autoritetet duhet të zgjerojnë bazën tatimore duke forcuar më tej administratën tatimore dhe atë doganore për të zvogëluar informalitetin.** Mbledhja duhet të përforcohet duke vendosur caqet sasiore dhe strategjike të performancës, duke zgjeruar kërkesat për deklarim tatimor, përmirësuar efikasitetin dhe produktivitetin e kontrolleve dhe përmirësuar ndjeshëm mbledhjen e borxheve. Për të përmbushur cakun e të hyrave buxhetore për 2018 (që përfshin përfitime nga përmirësimet në administratën tatimore), autoritetet janë duke përgatitur reforma specifike të administratës tatimore dhe doganore, të cilat duhet të fillojnë së zbatuari. Duhet të shmangët aplikimi i pushimeve ose përjashtimeve tatimore që do të mund të dobësonin bazën tatimore.
- **Programet e përfitimeve sociale duhet të reformohen për të adresuar në mënyrë më efektive pabarazinë, varfërinë dhe papunësinë brenda kornizës ekzistuese të shpenzimeve.** Kjo përfshin forcimin e mekanizmave për të siguruar se nuk ka përfitime të dyfishta, testim më të mirë të mjeteve, heqje të stimulujve për të qenë i papunë, administrim të rreptë dhe zbatim të kriterëve të pranueshmërisë së skemave, si dhe sigurimin e një sistemi më të barabartë, për shembull përmes harmonizimit të pragut të aftësisë së kufizuar dhe pagesave për veteranët e luftës me atë të përfitimit të aftësisë së përgjithshme të kufizuar. Tutje, në fillim të vitit 2018 duhet të kryhet një proces i besueshëm i rikategorizimit dhe verifikimit të veteranëve të luftës, në përputhje me ligjin, gjë që është thelbësore për të siguruar se shpenzimet sociale qëndrojnë brenda kornizës buxhetore. Misioni bën thirrje që të mos futen skema jokontributdhënëse të pensionimit të hershëm për grupe të veçanta (siç është ai për policinë) meqë kjo do të minonte trajtimin e drejtë dhe shëndetin financiar të sistemit të pensioneve.
- **Duhet të përmirësohet efikasiteti i shpenzimeve në shëndetësi dhe arsim.** Niveli dhe rezultatet e shpenzimeve në shëndetësi dhe arsim janë të dobëta. Misioni mirëpret rritjen e ndarjes buxhetore për 2018 dhe i bën thirrje autoriteteve që t'i përshpejtojnë reformat në përmirësimin e efikasitetit në sistemin shëndetësor për të mbajtur shpenzimet në kontroll pasi që të fillojë së zbatuari sistemi i ri i sigurimeve. Gjithashtu, baza e kontributit duhet të zgjerohet për të siguruar të hyra të mjaftueshme. Reformat gjithëpërfshirëse në arsim duhet të avancojnë tutje për t'i ngritur shkathtësitë dhe për t'i trajtuar mospërputhjet, të cilat shpeshherë janë cekur si një nga pengesat kryesore të rritjes.
- **Fatura e pagave duhet të sigurojë hapësirë për punësim në sektorët prioritarë brenda kufijve të rregullës.** Misioni rekomandon që rritjet e pagave të përgjithshme të jenë më të kufizuara, duke pasur parasysh nivelin veçse të lartë të pagave në sektorin publik. Kjo do të krijonte hapësirë për punësime prioritare në gjyqësor, shëndetësi dhe arsim. Kjo gjithashtu do të zvogëlonte presionin e pagave të sektorit publik mbi ato të sektorit privat.

- **Kuadri i investimeve publike duhet të forcohet për të rritur efikasitetin e shpenzimeve kapitale dhe për të përmirësuar absorbimin e financimit të donatorëve.** Kjo përfshin futjen e kërkesës për analiza të kostove dhe përfitimeve të projekteve madhore kapitale, forcimin e vlerësimit, përzgjedhjes, përgatitjes dhe ekzekutimit të projekteve; aplikimin e buxhetimit shumëvjeçar; dhe sigurimin e auditimit të pavarur ex-post dhe vlerësimin e projekteve të mëdha.

Duhet të diversifikohet financimi, dhe të ulen kostot dhe rreziqet e zbatimit të tij. Misioni mirëpret zgjatjen e vazhduar të maturimeve, por kërkon përmirësim të absorbimit të financimit në dispozicion të IFN/BE (sidomos për investime) për të minimizuar tkurrjet si pasojë e normalizimit të politikës monetare në euro. Në përputhje me zhvillimin e tregut të borxhit të brendshëm, misioni inkurajon autoritetet që të promovojnë një bazë të diversifikuar të pjesëmarrësve në tregjet primare dhe sekondare.

Sektori financiar: Mbështetja e rritjes ekonomike përmes thellimit dhe stabilitetit financiar

Bankat e Kosovës janë të kapitalizuara mirë, likuide dhe profitabile, por mbikëqyrja e bankave mund të forcohet tutje. Në veçanti, misioni mirëpret nivelin e ulët të kredive joperformuese dhe provizionimin adekuat. Pavarësisht kësaj, autoritetet duhet të vazhdojnë të forcojnë kornizën e tyre mbikëqyrëse, për shembull duke avancuar punën në zhvillimin e manualit për ekzaminimi të bankave *off-site* dhe forcuar tutje kuadrin e tyre makroprudencial.

Gjithashtu, nevojiten përpjekje të tjera për thellimin e ndërmjetësimit financiar. Penetrimi kreditor është rritur gjatë viteve të fundit, dhe normat e interesit kanë pësuar rënie të ndjeshme. Megjithatë, në nivel prej 38 për qind të BPV, ajo është e ulët në krahasim me vendet e tjera të CESEE dhe Ballkanit Perëndimor. Për më tepër, rritja më e madhe kreditore ka qenë në lëshimin e kredive hipotekare dhe ato të pasiguruara konsumuese, ndërkohë që kreditimi për sektorët prodhues mbetet i ulët. Prioritetet e reformës për të siguruar kreditim më të madh dhe më të balancuar përfshijnë zbatimin e plotë të Ligjit të ndryshuar për procedurat e përmbartimit, adresimin e ngarkesës ende të madhe të lëndëve gjyqësore, krijimin e një regjistri plotësisht funksional pronësor që mbulon të gjithë Kosovën dhe lejimin e bankave për të pasur qasje në regjistrin bujqësor. Është gjithashtu kritike që autoritetet të vazhdojnë të tregojnë vigjilencë mbikëqyrëse në kreditimin e fortë dhe të qëndrueshëm konsumues dhe ndërtimor.

Neni VIII

Ekspertët ligjorë dhe financiarë që iu bashkuan misionit konstatuan se Kosova nuk ka praktika të valutave të shumëfishta dhe kufizime në realizimin e pagesave dhe transfereve për transaksionet aktuale ndërkombëtare, përveç masave sanksionuese të aplikuara vetëm për qëllime të sigurisë ndërkombëtare apo kombëtare. Autoritetet presin të kalojnë së shpejti në statusin e Neni VIII nga Neni XIV (status ky kalimtar në dispozicion të shteteve të reja anëtare në Fond).